

VENDIM
Nr. 545, datë 4.9.2024

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 285, DATË 19.5.2021, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË
PROKURIMIT PUBLIK”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7, pika 2; 13, pika 1, shkronja “a”; 14, pika 3; 17, pikat 1 dhe 2; 21, pika 4; 23, shkronjat “c” dhe “gj”; 33, pika 2; 34, pika 2; 35, pika 3; 41, pika 2; 42, pikat 1 dhe 3, shkronja “a”; 43, pikat 1 dhe 4, shkronja “a”; 44, pika 1; 54, pika 1; 56, pika 4; 57, pikat 1 dhe 2, shkronja “c”; 58, pika 2; 71, pikat 1 dhe 2, shkronja “c”; 72, pika 1; 74, pika 1; 78, pika 3; 82, pikat 1 dhe 5; 111, pika 1; 114, pika 5; 116, pika 4; 124, pika 6; 131, pika 2; e 132, pika 2, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin bashkëlidhur vendimit nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në shkronjën “d”, të pikës 4, të nenit 41, “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, fjalët “Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence” ...” zëvendësohen me “Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, ...”.

Neni 2

Në pikën 3, të nenit 99, “Paraqitja e argumenteve nga operatorët ekonomikë të interesuar”, bëhen këto ndryshime:

1. Në fjalinë e parë, togfjalëshi “... 10 (dhjetë) ditë ...” zëvendësohet me “... 7 (shtatë) ditë ...”.
2. Në fjalinë e dytë, togfjalëshi “... 7 (shtatë) ditë ...” zëvendësohet me “... 5 (pesë) ditë ...”.

Neni 3

Në pikën 5, të nenit 100, “Afatet e shqyrtimit të ankesave nga autoriteti/enti kontraktor”, fjalët “... brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, ...” zëvendësohen me “... brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti/enti kontraktor për procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar dhe brenda 10 (dhjetë) ditëve për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ...”.

Neni 4

Në fjalinë e dytë, të pikës 9, të nenit 107, “Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës”, fjalët “... të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike, i dërguar ...” zëvendësohen me “... , të publikuar nga APP-ja, pas dërgimit të këtij çmimi për publikim ...”.

Neni 5

Dispozitë e fundit

Ngarkohen autoritetet dhe entet kontraktore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama